

Dit is een vertaling uit het Nederlands van de Frequently Asked Questions (FAQ) op www.stad.gent/corona (versie van 25 maart 2020)

Ky është një përkthim nga holandishtja i pyetjeve më të rëndësishme - Frequently Asked Questions (FAQ) tek www.stad.gent/corona (versioni 25 mars 2020)

Edhe bashkia e Gent-it ka ndryshuar mënyrën e shërbimeve. Në këtë mënyrë ne duam të ndalojmë bashkë me ju, koronavirus-in. Këto masa hyjnë në fuqi në 18 mars dhe marrin fund normalisht në 5 prill, gjithmonë nëse nuk vendoset një datë tjetër.

Nuk e gjeni përgjigjen e pyetjes tuaj? Na kontaktoni me anë të Gentinfo tek gentinfo@stad.gent ose 09 210 10 10.

Wat moet je doen als je ziek bent?

Çfarë duhet të bëni nëse jeni sëmurë?

- Keni temperaturë, dhimbje gryke, kollë, nuk mbusheni dot mirë me frymë, hundët që ju rrjedhin? Mos shkoni tek mjeku por kontaktoni mjekun tuaj të familjes me anë të telefonit.
 - Nga e hëna deri të premten nga ora 08:00 deri në 19:00
 - Merrni në telefon mjekun tuaj të familjes.
 - Nuk keni një mjek familjeje? Kontaktoni një mjek familjeje në lagjen tuaj. Këtu gjeni [një pasqyrë të të gjithë mjekëve të familjes në Gent](#).
 - Nga e hëna deri të premten nga ora 19:00 deri në orën 08:00 dhe në fundjavë:
 - Merrni në telefon nr. **1733**
 - Mjeku i familjes do t'ju vizitojë nëpërmjet telefonit dhe do të vendosë se cila është zgjidhja më e mirë në situatën tuaj.
 - Duhet të rri në shtëpi në karantinë.
- OSE
- Ju jepet një takim për një vizitë.
- Keni shqetësime të tjera, keni nevojë për një raport të ri, etj? Gjithmonë kontaktoni fillimisht mjekun e familjes me anë të telefonit.

De Dienstverlening

Shërbimet e bashkisë

1. Zyra e gjendjes civile (masat e vlefshme deri në 5 prill)
 - Është më mirë të na kontaktoni me [anë të faqes së internetit](#) dhe me anë të telefonit, si për takime në qendrën administrative (Administratie centrum) ashtu edhe për në qendrat e shërbimeve (dienstcentra).
 - Duhet të jeni patjetër prezent? Atëhere lini një takim [online](#) ose me anë të [Gentinfo](#). Takimet janë vetëm të mundura paradite të hënën, të martën, të mërkurën dhe të premten nga ora 09:00 deri në 12:30.
 - **Tek sporteli për të huajt (Loket Migratie) dhe pika e informacionit për të huajt (Infopunt Migratie) nuk mund të lini takim** as mund të shkoni pa orar. Këto sportele janë të disponueshëm me anë të telefonit dhe e-mail-it.
 - Sporteli për të huajt (Loket Migratie): **09 266 71 50** dhe loketmigratie@stad.gent.
 - Pika e informacionit për të huajt (Infopunt Migratie): **09 266 71 40** dhe infopuntmigratie@stad.gent.

- Qendra e shërbimeve e lëvizshme (Mobiel dienstencentrum) dhe qendrat e shërbimeve (dienstencentra) Muide-Meulestede dhe Sint-Kruis-Winkel janë të mbyllura.
 - Regjistrimet e veçanta
 - Për regjistrimin e një **lindjeje** nuk ka nevojë të vini tek ne. Në maternitet juve ju jepen formularët e nevojshëm. Këto ju i plotësoni dhe i dërgoni me e-mail tek geboorten@stad.gent. Procedura e njohjes së fëmijës (për çiftet e pamartuara) si fëmija yt do bëhet më vonë.
 - Për regjistrimin e një **vdekjeje** mund të lini patjetër një takim.
2. Zyrat e OCMW's për mirëqënien (welzijnbureaus) – (masa të vlefshme deri në 19 prill)
 - Keni një dosje të hapur tek ne? Atëhere kontaktoni punonjësën tuaj social mundësisht me anë të telefonit ose e-mail-it.
 - Nëse nuk arrini dot të lidheni me anë të telefonit apo e-mail-it, ejani në një nga zyrat tona midis orës 08:30 dhe 12:30 dhe midis orës 13:30 dhe 17:00 nga e hëna deri të premten. Zyrat janë hapur, por punojnë me kapacitet të limituar.
 - Ne i kemi anuluar të gjitha takimet, si vizitat në shtëpi ashtu edhe orarin e pritjes në zyrë. Punonjësit social ju kontaktojnë me anë të telefonit.
 - Ne do vazhdojmë t'ju paguajmë ndihmën financiare. Edhe kërkesat e reja për mbështetje financiare do shqyrtohen.
 3. Qendrat lokale të shërbimeve (lokale dienstencentra) – masa të vlefshme deri në 13 prill.
 - 11 qendrat lokale të shërbimeve të bashkisë së Gent-it janë të mbyllura dhe të gjitha aktivitetet janë anuluar.
 - Ne do vazhdojmë t'ju ofrojmë shërbimet tona:
 - Bashkëpunëtorët tanë do të mbështesin njerëzit në nevojë me vizita shtëpie dhe kontakte telefonike.
 - Vaktet e ngrohta do vazhdojnë të çohen në shtëpi.
 4. Azilet për të moshuarit - masa të vlefshme deri në 19 prill.
 - 5 qendrat e perkujdesjes ndaj të moshuarve (azilet) janë të mbyllura. Nuk lejohen vizitorë, përveç familjarve që perkujdesen për të moshuarin dhe vullnetarëve që janë regjistruar në azilin përkatës.
 5. Qendrat e lagjes (buurtcentra) dhe shtëpitë e hapura (open huizen) – deri në 19 prill.
 - Të gjitha shtëpitë e hapura dhe qendrat e lagjes janë të mbyllura.
 - Shtëpinë e hapur në qendren e lagjes Gentbrugge mund ta kontaktoni me anë të telefonit nga ora 08:30 deri në 12:30 dhe midis 13:30 dhe 17:00 nga e hëna deri të premten në numrin **0478 93 25 73**.
 - Qendrat janë të disponueshme për organizatat me të cilat bashkëpunojnë për ndarjen e ushqimit. Ato ndjekin të gjitha rregullat rreth sigurisë.

Huwelijken

Martesat

- Shtyjeni martesën tuaj për një datë më të vonshme. Zyra e gjendjes civile (dienst Burgerzaken) do ju kontaktojë rreth kësaj.
- Nëse martesë duhet të zhvillohet patjetër për arsye të forta, atëhere vetëm personat e mëposhtëm mund të jenë prezent:
 - Çifti që do martohet
 - 2 dëshmitarë
 - 1 fotograf

Edhe në këtë rast duhet të mbani gjithnjë distancë prej 1.5 metrash nga njëri tjetri.

Begraafplaatsen

Varrimet

- Ne organizojmë varrime, por nuk lejohen më shumë se 20 persona present.
 - Kujdesuni për distancë të mjaftueshme midis njerëzve
 - Kujdesuni për distancë midis njerëzve dhe punonjësve të firmës funerale dhe bashkisë së Gent-it.
- Përkujtimoret do të shtyjmë.
- Zyra në Westerbegraafplaats është e mbyllur.

Afval

Mbeturinat

IVAGO do vazhdojë të mbledhi mbeturinat dhe plehrat e hedhura në vendet e gabuara sipas [planit të paracaktuar](#). Mund ti nxirrni mbeturinat jashtë banesës si gjithmonë.

Geloof

Besimi

Të gjitha shtëpitë e lutjes (kisha, xhami,...) janë të mbyllura për publikun. Vetëm ceremonitë mortore mund të organizohen me një numër njerëzish të kufizuar.

Kinderopvang

Mbajtja e fëmijëve

- Mbajini fëmijët sa më shumë në shtëpi. Kjo është një direktivë e Këshillit Nacional për sigurinë.
- Nëse fëmija juaj nuk shkon në çerdhe, kopsht, edukatore private, si pasojë e kësaj direktive, atëherë ju nuk duhet të paguani asgjë nga data 14 mars deri 5 prill dhe kjo as nuk regjistrohet si mungesë, nuk ka nevojë të përdorni ditët e pushimit të justifikuar (gafdagen).
- Prindërit që duhet të vazhdojnë punën, sidomos ata që janë të punësuar në [sektoret kyç dhe shërbimet esenciale](#) mund ti sjellin fëmijët në kopshte, çerdhe, dhe edukatoret e bashkisë së Gent-it.
- Keni pyetje? Kontaktoni me anë të e-mail-it kinderopvang@stad.gent

Onderwijs

Arsimi

- Mbajini fëmijët sa më shumë të jetë e mundur në shtëpi. Kjo është një direktivë e Këshillit Nacional për sigurinë.
- Si rrjedhojë, të gjithë kopshtet, shkollat fillore dhe të mesme nuk japin mësim.
- Ka mundësi qëndrimi në shkollë për të gjithë fëmijët, prindërit e të cilëve duhet të shkojnë në punë:
 - Në sektorin e shëndetit
 - Në një nga [sektoret publike esenciale](#)
 - Ose për prindër që nuk kanë mundësi tjetër përveçse ti çojnë fëmijët të rrinë te gjyshërit.

Mobiliteit

Transporti

- Transporti publik do qëndrojë aktiv. Kontrolloni faqet e internetit të De Lijn dhe NMBS për oraret dhe kufizohuni vetëm tek lëvizjet e domosdoshme. Pagesat me para në dorë nuk janë më të mundshme në autobus, tram dhe dyqanet e De Lijn. Hipni ne derën e pasme në autobus.
- Biçikletën mund ta çoni për riparim tek Fietsambassade. Ata ofrojnë ndihmë për rastet kur biçikleta përdoret për lëvizje të domosdoshme. Kjo është e mundur vetëm pasi të lini takim me anë të **09 266 77 00**. Fietspunten (vendet ku mund të merrni me qera një biçikletë) dhe Fietsendepot (magazina ku mblidhen biçikletat e parkuara gabim) do mbyllen.

- Shërbimet shuttle midis Park&Ride Watersportbaan dhe Weba/Decathlon me qendrën e qytetit do vazhdojnë punën.
- Ju mund të vazhdoni të përdorni makinat me qera, biçikletat me qera dhe steps me qera për lëvizjet e domosdoshme. Kjo nuk është e ndaluar.

Lage-emissiezone (LEZ)

Zona e emetimit të ulët

- Bashkia e Gent-it do adaptojë rregullat e zonës së emetimit të ulët nga 18 marsi derisa qeveria federale të anulojë masat e marra rreth koronavirus-it. Kamerat do vazhdojnë të regjistrojnë automjetet që shkelin rregullat e zonës së emetimit të ulët, por ju nuk do të merrni gjobë. Në këtë mënyrë bashkia e Gent-it do të ndihmojë në mënyrë maksimale ata njerëz që përkujdesen për mirëqënien dhe shëndetin e të tjerëve.
- Keni një pas ditor (dagpas) për zonën e emetimit të ulët apo keni blerë një leje të përkohshme për një kohë të gjatë, por për arsye të koronavirusit nuk mund të vini më në Gent? Kërkoni atëhere me anë të e-mail-it tek lez@stad.gent t'ju rimburojnë, duke dërguar numrin e targës dhe datën e pasit ditor ose periudhën e lejes së përkohshme që kishit marrë. Specifikoni nëse doni të rimburoheni apo doni që pasin ditor apo lejen e përkohshme të mund t'i përdorni më vonë. Ju duhet të anuloni para se pasi ditor apo leja e përkohshme të ketë filluar. Pra nëse përshembull kishit blerë një leje të përkohshme për ta përdorur në muajin prill 2020 në zonën LEZ, atëhere këtë mund ta anuloni në kohë deri në 31 mars 2020.
- Keni pyetje rreth LEZ?
 - Mund të drejtoheni tek numri 09 210 10 30 ose mund ti nisni pyetjet tuaja me e-mail tek lez@stad.gent
 - Doni të vini fizikisht për një takim? [Lëre takimin online.](#)

Handel en horeca

Tregtia dhe horeca (hotelet, restorantet, kafenetë)

- Cilat dyqane janë të hapura?
 - Dyqanet ushqimore (edhe dyqanet e natës deri ne orën 22:00)
 - Dyqanet me ushqime kafshësh
 - Farmacitë
 - Dyqanet e gazetave
 - Stacionet e benzinës dhe furnizuesit e lëndëve djegëse
 - Bankat dhe zyrat e postës
 - Lavanderitë
 - Garazhet (vetëm për riparimet urgjente)
- Cilat dyqane janë të mbyllura?
 - Të gjitha dyqanet e tjera (jo esenciale) si psh.: dyqane rrobash, dyqane këpucësh, lavazhet e makinave, dyqane me materiale ndërtimi dhe dyqanet e elektronikës do jenë të mbyllura si gjatë javës ashtu edhe gjatë fundjavës.
 - Kafenetë dhe restorantet
 - Tregjet
 - Sallonet e bukurisë dhe solaret
- Në supermarket duhet të keni parasysh këto rregulla:
 - Lejohen brenda në dyqan maksimumi 1 person për 10 metra katror.
 - Mund të rrini maksimumi 30 minuta brenda në dyqan.
 - Nëse ka shumë njerëz, prisni jashtë.
 - Furnizimi dhe prodhimi i ushqimeve vazhdon normalisht. Pra nuk është e nevojshme të blini me sasi të mëdha, blini thjesht ato që ju duhen.

Werken en ondernemen

Puna dhe privatët

- Jeni pronar i një kafeneje, restoranti apo hoteli?
 - Ju duhet ta mbyllni biznesin tuaj, por mund të përgatisni ushqime që i shisni të gatshme si 'take away' nga ora 7:00 deri në 22:00.
 - Kjo do të thotë që dyqanet e patateve të skuqura (frituren)/dyqanet e sanduiçeve/restorantet etj. mund të vazhdojnë t'ju shërbejnë me **"take away" (blerjes së ushqimit të gatshëm për ta konsumuar në shtëpi) apo sjelljes në shtëpi**. Respektoni gjithnjë masat rreth higjienës dhe mënjaroni rradhët e gjata.
 - **Të hani ose të pini në njësinë shitëse nuk është e lejuar**. As nëpër tarracat e këtyre njësive. Është e ndaluar të vendosni mobilje tarrace në zonën publike.
 - Konkretisht kjo do të thotë që ju duhet t'i hiqni të gjitha mobiljet e tarracës së kafenes/dyqanit/restorantit apo hotelit tuaj, nga rruga.
 - **Foodtrucks** (makinat që shesin ushqime të përgatitura) ndalohen, përveçse foodtrucks që shesin vakte ushqimore (pra nuk shesin akullore ose wafels).
- A keni të drejtë për ndihmë financiare nëse firma juaj është në vështirësi si pasojë e masave ndaj koronavirus-it?
 - Si [geveria federale](#) ashtu edhe [geveria Flamande](#) kanë hartuar masa mbështetëse për firmat që kanë vështirësi si pasojë e koronavirus-it, si psh. një [shpërblim në rast pengese](#) (hinderpremie). Më shumë informacion gjeni tek [Vlaio.be](#).
 - Bashkia e Gent-it ka marrë gjithashtu disa masa.
 - Bashkia e Gent-it ka shtyrë përshembull, të gjitha pagesat e taksave të firmave për vitin 2020 deri në 30 shtator 2020.
 - Taksat për aktivitete që nuk mund të zhvillohen (tarraca, reklamat që vihen në rrugë, pagesat për tezgat e tregjeve, ...) nuk duhet ti paguani që prej 13 marsit deri sa këto masa të mos jenë më në fuqi.
 - Bashkia e Gent-it po shikon nëse mund të marri masa të tjera ekonomike. Sapo të kemi më shumë informacion rreth kësaj, do t'ju njoftojmë.

Cultuur, sport en vrije tijd

Kultura, sporti dhe koha e lirë

- Ne anulojmë të gjitha aktivitetet për të rinjtë dhe evenimentet deri në 5 prill.
- Edhe kampet e pushimit dhe aktivitetet për të rinjtë gjatë pushimeve të Pashkës janë anuluar.

Gent Helpt: Extra hulp van vrijwilligers

Gent-i ndihmon: ndihmë ekstra nga vullnetarët

- Bashkia e Gent-it ka përmbledhur të gjitha kërkesat për ndihmë gjatë krizës së koronavirus-it tek faja e internetit [Gent Helpt](#).
- Doni t'ju ofroni ndihmë fqinjëve tuaj? Ju mund të shkarkoni në internet një [kartë](#) të cilën mund ta ngjisni në dritaren tuaj ose tua jepni komshinjve tuaj (në kutinë e tyre të postës). Kështu ata do e dinë që mund të drejtohen tek ju.
- Keni vetë nevojë për ndihmë? Shkarkoni këtë [kartë](#) në internet dhe ngjiteni në dritaren tuaj ose futeni tek kutia e postës së fqinjëve. Kështu ata do ta dinë që ju keni nevojë për ndihmë.
- Departamenti Ouderenzorg (Departamenti i kujdesit ndaj të moshuarve) i bashkisë së Gent-it ju kërkon të njoftoni situatën kritike të të moshuarve në nr. e telefonit **09 266 91 39** ose me anë të e-mail-it communicatie.ouderenzorg@stad.gent

Politie

Polcia

- Sportelet e pritjes janë mbyllur por dy sportele të mëdha të policisë janë hapur nga ora 08:00 deri në 16:30:
 - [Algemeen Politiecentrum Gent](#) (Ekkergem)
 - [Commissariaat Gent Centrum](#)
- Ju kërkohet të shtyni për më vonë **denoncimet jo-urgjente**.
 - Disa lloj denoncimesh jo-urgjente mund t'i bëni me anë të faqes së internetit: [Police-On-Web](#).
Përshembull vjedhjet e biçikletës apo motoçikletës, vjedhje në dyqane, dëmtime apo grafitë.
- Jeni në rrezik, atëhere merrni numrin e **emergjencës 101 ose 112**.
- Shikoni që një dyqan, restorant apo kafene nuk i respekton masat e marra nga qeveria dhe është hapur, mund të lajmëroni në numrin [09 266 61 11](tel:092666111) ose me anë të e-mail-it meldpunt@politie.gent.be.